



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
KUÇOVË

Nr. 2474 Prot.

Kuçovë, më 08.08. 2022

V E N D I M

Nr. 42, datë 08/08/2022

**“Për Miratimin e Hartimit të Planit Lokal të Zvogëlimit të riskut të Fatkeqësive në
Bashkinë Kuçovë”.**

Këshilli Bashkiak, pasi u njohë me materialin e paraqitur nga Komisioni i Emergjencave Civile, mbështetur në ligjin 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji nr.45/2019 “ Për Mbrojtjen Civile”, si dhe në zbatim të V.K.M nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmes shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

VENDOSI:

- 1.“Të Miratoj Hartimin e Planit Lokal të Zvogëlimit të riskut të Fatkeqësive në Bashkinë Kuçovë”.
- 2.Ngarkohet kryetari i Bashkisë, Komisioni i Emergjencave Civile, Sektori i Emergjencave Civile si dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për të ndjekur zbatimin e këtij vendimi.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

Ky vendim u miratua me 16 pro, - abstenim, 1 kundër ,në prani të 17 këshilltarëve.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK
MIGENA BULLARI

